REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax:+355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. K4/I11-3 **Prot.** **Tiranë 27/08/2025**
Nr. Dok. 202500136/3

Lënda: *Rekomandime për inspektimin e kryer në Komisariatin e Policisë Kavajë.*

Drejtuar: **Z. Vilson BALA**

Drejtor i Drejtorisë Vendore të Policisë

DURRËS

Z. Luan HAMZALLARI

Shef i Komisariatit të Policisë

KAVAJË

Për dijeni: **Drejtues Madhor z. Ilir PRODA**

Drejtor i Përgjithshëm i Policisë të Shtetit

TIRANË

Të nderuar,

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin e deritanishëm dhe duke vlerësuar angazhimin dhe punën e të gjithë stafit të institucionit që ju drejtoni, si dhe frymën e mirë të bashkëpunimit dhe mirëkuptimit midis institucioneve tona, në vijim po ju njohim mbi gjetjet e inspektimit që institucioni i Avokatit të Popullit kreu në Komisariatin e Policisë Kavajë më datë 7.02.2025.

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues, në vijim Mekanizmi Kombëtar (MKPT), seksion pranë Avokatit të Popullit, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, *"Për Avokatin e Popullit"*, i ndryshuar, kreu një inspektim në Komisariatin e Policisë Kavajë.

Inspektimi u krye sipas Planit Vjetor Inspektimi të MKPT-së të miratuar nga Avokati i Popullit. Në përbërje të grupit të inspektimit ishin znj. Gloria Çarkaxhiu dhe znj. Nertila Qafzezi, me detyrë nd/komisionere pranë Mekanizmit Kombëtar.

Inspektimi kishte si qëllim verifikimin e respektimit të standardeve të përcaktuara në ligjin nr.82/2024 "Për Policinë e Shtetit", Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 894, datë 19.07.2022, për miratimin e procedurës standarde *"Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë"*, Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 1543, datë 19.11.2024, për miratimin e procedurës standarde *"Ndalimi i përkohshëm policor"* dhe Urdhrin nr. 1720, datë 20.11. 2023 për miratimin e procedurës standarde *"Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre"*. Inspektimi ishte i paparalajmëruar.

Institucioni i Avokatit të Popullit, pasi u njoh me konstatimet e grupit inspektues dhe nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga inspektimi i vitit të kaluar, ka detyrimin ligjor t'ju parashtrojë konkluzionet përfundimtare, që do të gjeni më poshtë:

Shënime të përgjithshme

Grupi i inspektimit të MKPT-së, në përputhje me metodologjinë e zhvillimit të inspektimit për institucionet ku mbahen dhe trajtohen shtetasit e privuar nga liria, zhvilloi takim me shefin e Komisariatit të Policisë Kavajë z. Luan Hamzallari, i cili u vu në dijeni të qëllimit të inspektimit.

Në vijim, Shefi i Komisariatit raportoi për grupin e inspektimit, mbi masat e marra për realizimin e rekomandimeve të lëna nga Institucioni i Avokatit të Popullit në inspektimin e mëparshëm, për përmirësimin e ambientit të shoqërimit, sipas kushteve dhe kritereve të përcaktuara në procedurat standarde dhe aktet ndërkombëtare për këtë qëllim.

Pasi mori informacionin e nevojshëm, grupi i punës vijoi takimin me punonjësin e dhomave të shoqërimit, dhe inspektoi ambientet e shoqërimit, u njoh me regjistrat dhe dokumentacionin ku pasqyrohen të dhënat dhe veprimet e kryera me personat e shoqëruar dhe të arrestuar apo ndaluar, si dhe vizitoi zyrat e punës të punonjësve të policisë të këtij komisariati.

Nga verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit pas inspektimit të mëparshëm[1], grupi i inspektimit evidentoi se:

[1] Shkresa nr. K4/I25-2 prot., datë 29.07.2024 dërgohen *"Rekomandime për inspektimin e kryer në Komisariatin e Policisë Kavajë".*

- Ishte zbatuar rekomandimi, për kontrollin e vazhdueshëm të zyrave të oficerëve të policisë gjyqësore në të cilat merren në pyetje shtetasit, si dhe heqjen e menjëhershme të të gjitha sendeve të cilat mund të ekspozojnë dhunë psikologjike/fizike tek personat me të cilët ata kryejnë veprime procedurale.
- Ishte zbatuar rekomandimi, për kompletimin me orenditë e nevojshme si tavolinë pune dhe karrige (me këmbë të fiksuara në dysheme), për qëndrimin ulur të të shoqëruarve në dhomën e shoqërimit për të rritur.
- Ishte zbatuar rekomandimi, për plotësimin e dokumentacionit me hapjen dhe vënien në funksion të regjistrit për evidentimin e kërkesë/ankesave të personave të shoqëruar dhe të arrestuar/ndaluar, sikurse parashikohet në nenin 115 "*Kërkesë/ankesat e të shoqëruarve, të ndaluarve dhe të arrestuarve*" të ligjit nr. 108/2014 "*Për Policinë e Shtetit*", i ndryshuar.
- Ishte zbatuar rekomandimi, për përditësimin e listës së Avokatëve kryesisht në dhomat e shoqërimit si dhe evidentimin në regjistrin e informacionit të avokatëve kryesisht të pranishëm.

Ndërkohë, grupi i inspektimit konstatoi se disa nga rekomandimet nuk ishin realizuar, referuar si më poshtë vijon:

- Nuk ishte zbatuar rekomandimi, për krijimin e një mjedisi të veçantë për intervistimin e personave të mitur në konflikt me ligjin, i cili të jetë i pajisur me orenditë e nevojshme si tavolina pune për punonjësit e policisë, ndenjëse për qëndrimin ulur të të miturve, kujdestarit ligjor, psikologut dhe avokatit mbrojtës, si dhe të kompletuar me materiale informuese rreth të drejtave të të miturve të njohura nga legjislacioni kombëtar dhe konventat ndërkombëtare.
- Nuk ishte zbatuar rekomandimi, për krijimin e zyrave ku merren në pyetje shtetasit gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në këto zyra.
- Nuk ishte zbatuar rekomandimi, për sigurimin e dritareve të dhomave të shoqërimit të grave dhe të miturve sipas Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 894, datë 19.07.2022, për miratimin e procedurës standarde *"Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë".*
- Nuk ishte zbatuar rekomandimi, për sigurimin e ngrohjes/ftohjes nëpërmjet vënies në punë të sistemit qëndror në dhomat e shoqërimit dhe të sigurisë, në varësi të stinës dhe temperaturave.

Theksojmë se, drejtuesi dhe punonjësit e policisë të komisariatit me të cilët kontaktoi grupi i inspektimit, u treguan bashkëpunues gjatë vizitës inspektuese që u zhvillua në ambientet e këtij Komisariati, megjithëse disa nga rekomandimet të cilat kanë implikime financiare mbeteshin ende të pazbatuara. Për këto rekomandime institucioni i është drejtuar Drejtorisë Vendore të Policisë Durrës me shkresën nr. 3752 prot., datë 03.09.2024, me lëndë "*Kërkesë për mbështetje*", për mbështetje në zbatimin e tyre.

Ambientet e shoqërimit dhe kushtet e tyre

Në Komisariatin e Policisë Kavajë, ambientet e shoqërimit përgjithësisht ishin realizuar sipas parashikimeve të bëra në ligjin nr. 82/2024, "*Për Policinë e Shtetit*", dhe procedurës standarde dhe Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.894, datë 19.07.2022, për miratimin e procedurës standarde *"Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë"* ku parashikohet se dhomat e shoqërimit duhet të jenë me sipërfaqe dhe hapësira të bollshme për qëndrim, si dhe të ndara më vete për gratë, meshkujt madhorë dhe të miturit.[2]

Ambienti i shoqërimit ndodhej në katin e parë të ndërtesës së komisariatit dhe kishte 3(tre) dhoma shoqërimi, të ndara më vehte për personat e rritur, gra dhe të mitur.

Parametrat teknikë të dhomave të shoqërimit ishin të tilla që mundësonin sipërfaqe dhe hapësirë të bollshme për mbajtjen dhe qëndrimin ulur në kushte normale të të shoqëruarve. Përmasat e dhomave janë 4x4m dhe kapaciteti fizik është për mbajtjen dhe qëndrimin ulur deri 10 persona të shoqëruar (2-3 persona në dhomë).

Dhomat e shoqërimit ishin të kompletuara me orenditë e nevojshme si tavolinë pune dhe karrige (me këmbë të fiksuara në dysheme), për qëndrimin ulur të të shoqëruarve. Dyert e dhomave mbyllen me çelës nga jashtë, i cili mbahej nga punonjësi i policisë në zyrën e informacionit. Dyert dhomave të shoqërimit për gratë dhe të miturit në pjesën e sipërme të derës **nuk kishin** hapësirën me përmasa 60x40 cm, në të cilën montohet një xham transparent dhe i armuar (i pa çmontueshëm dhe rezistent/i pathyeshëm ndaj goditjeve me grushte, shkelma, kokë). Hapësira e dritares/sportelit të derës nga ana e korridorit të dhomave sigurohet me një rrjetë teli me shufra me seksion/trashësi 0,6 mm të cilat vendosen në mënyrë vertikale dhe horizontale duke krijuar kuadrate 5x5cm.[3] Dhomat e shoqërimit **nuk kishin as sistem ngrohje/ftohje**.

Dritaret e dhomave të shoqërimit kanë përmasa të tilla të cilat mundësojnë ajrim dhe ndriçim të plotë natyral. Dritaret në dhomën e shoqërimit të të rriturve në pjesën e brendshme janë të siguruara me rrjetë të hollë hekuri, për arsye të sigurisë të personave që qëndrojnë në këto ambiente, ndërsa dritaret e dhomave të shoqërimit të grave dhe të miturve **nuk ishin të siguruara** me zgarën e hekurit me shufra vertikale dhe horizontale me trashësi/seksion 18 mm dhe me kuadrate 15 x 15cm, të fiksuara në faqet anësore të dritares si dhe me rrjetën e hollë të hekurit në brëndësi të tyre. Dhomat

[2] Pika 4 e procedurës standarde *"Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë". e.1 Në njësitë vendore policore ndërtohen ambientet e shoqërimit të ndara më vete për personat madhorë, të mitur dhe femra, të cilat kanë sipërfaqe nga 16-20 m² secila.*

[3] Pika e.6.4 e procedurës standarde *"Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë".*

e shoqërimit kanë edhe ndriçim artificial, që furnizohet nga rrjeti elektrik. Në rast ndërpreje të energjisë elektrike, ndërtesa furnizohej nga gjeneratori, që shërben si burim rezervë.

Mjediset dhe dhomat e shoqërimit ishin të pastra nga ana higjieno-sanitare dhe muret e brendshme të tyre, ishin të lyera dhe të mirëmbajtura.

Ngjitur me dhomat e shoqërimit ndodhej një tualet i përbashkët për meshkuj dhe gra, e pajisur me lavaman me rubinet dhe nyje hidrosanitare, si dhe kishte furnizim me ujë të rrjedhshëm.

Në korridorin e ambientit të shoqërimit, ishin instaluar dy kamera sigurie për mbajtjen në vëzhgim të korridorit të këtij mjedisi, ndërsa brenda dhomave të shoqërimit **nuk kishte** kamera për monitorimin e këtyre ambienteve sipas kërkesave të shkronjës "*g*", të pikës 4, të Kreut VI, të Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 894, datë 19.07.2022, për miratimin e procedurës standarde *"Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë"*.[4] Pamjet e koridoreve të dhomave të shoqërimit monitoroheshin nëpërmjet një monitori të vendosur në sallën operative të komisariatit nga punonjësi i shërbimit të policisë.

Në ambientin e shoqërimit nuk kishte dhomë të veçantë për marrjen në pyetje/intervistimin e shtetasve. Në çdo rast, intervistimi i personave të shoqëruar kryhej në zyrat e punës të punonjësve të policisë. Njëkohësisht edhe kryerja e veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore dhe komunikimi i masës së sigurisë të personave për kalimin nga dhomat e shoqërimit në dhomat e sigurisë, kryhej në zyrat e punës së punonjësve të policisë.

Një nga problematikat e evidentuara e cila është trajtuar edhe më herët nga Avokati i Popullit është mungesa **e dhomave të intervistimit/marrjes në pyetje të personit në cilësinë e të shoqëruarit, të arrestuarit apo të ndaluarit, brenda mjediseve të Policisë së Shtetit**.[5]

a) Në komisariatet e policisë, ka mungesë të dhomave më vete për intervistimin/marrjen në pyetje të personave të shoqëruar/ndaluar/arrestuar që duhet të ndërtohen në këto mjedise;

[4] Shkronja "g" pika 4, Kreu VI parashikon se: "*Të gjitha ambientet e dhomave të shoqërimit monitorohen me sisteme të kamerave (përjashto tualetin) si ambienti i brendshëm i dhomave të shoqërimit, korridori i tyre dhe pjesa e jashtme e dhomave të shoqërimit, të cilat lidhen dhe transmetojnë pamjet/imazhet në monitorë të vendosur në shërbimin e Sallës së Komandimit/shërbimit të informacionit të DVP/komisariatit/stacionit të policisë*."

[5] Rekomandohet krijimi i ambienteve (dhomave) më vehte të intervistimit/ marrjes në pyetje të personave të privuar nga liria në mjediset e Policisë së shtetit. Nr.K4/I89-2Prot, datë 28.12.2023.

b) Mungon instalimi i pajisjeve të sigurisë audio-vizive për të regjistruar procesin e marrjes në pyetje apo veprimeve të tjera procedurale hetimore me të shoqëruarit/arrestuarit/ndaluarit.
Në Procedurën Standarde të Punës "*Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë*", me Urdhrin nr. 894, datë 19.07. 2022, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit përkatësisht në Kreun VI pika 4, gërma "i" përcaktohet qartë se:
"i. Pranë dhomave të shoqërimit dhe pjesë të këtij sistemi projektohen dhe ndërtohen ambiente të posaçme si:
i.1 Dhomë për intervistimin/marrjen në pyetje të personave të shoqëruar para se të akomodohen/futen në dhomat e sigurisë të DVP/komisariatit të policisë (personat që do të arrestohen/ndalohen).
i.1.1 Ky ambient përveç kushteve të përcaktuara për dhomat e shoqërimit duhet të plotësojë dhe këto kushte:
-Të ketë të instaluara tavolinë pune dhe karrige për oficerin e policisë gjyqësore dhe pajisje elektronike për dokumentimin e veprimeve procedurale që kryhen nga OPGJ (kompjuter, printer, letër, etj).
-Tavolinë pune dhe dy karrige për qëndrimin e avokatit mbrojtës dhe të personit të dyshuar/akuzuar i cili do të intervistohet, arrestohet/ndalohet, etj.
-Instalohen sisteme dhe pajisje për regjistrimin elektronik audio dhe video të të gjitha veprimeve procedurale që kryhen me personin e shoqëruar nga oficerët e policisë gjyqësore, para se personi të akomodohet në dhomat e sigurisë të DVP/komisariatit të policisë si i arrestuar/ndaluar."

Avokati i Popullit e konsideron procesin e intervistimit të personit në një ambient më vete, që të jetë i monitoruar nëpërmjet sistemit të kamerave të sigurisë, si një element parësor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, pasi monitorimi filmik ka efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme, si nga ana e të shoqëruarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e policisë së shtetit ndaj tyre.

Lidhur me këto fakte, Institucioni i Avokatit të Popullit i ka rekomanduar në mënyrë të përsëritur, Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Drejtorive Vendore të Policisë, marrjen e masave për krijimin e zyrave të posaçme, për marrjen në pyetje të shtetasve gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në këto zyra, por sikurse konstatohet nga inspektimet periodike të zhvilluara nga MKPT, ky rekomandim ende nuk është plotësuar.

Avokati i Popullit e konsideron të papranueshëm faktin që për një kohë të gjatë Policia e Shtetit nuk e ka zbatuar këtë standard të parashikuar nga kuadri normativ në fuqi.

Ndërkohë, vlerësojmë se në rastet e ndodhjes së ngjarjeve të rënda, si dhunime fizike, keqtrajtime apo të rasteve fatale të vdekjeve në ambientet e organeve të policisë, regjistrimi dhe ruajtja e filmimeve do të ishte një nga provat e rëndësishme për zbardhjen dhe identifikimin e autorëve të tyre. Me anën e regjistrimit audio-viziv mund të verifikohet dhe provohet nëse i arrestuari/ndaluari ka qenë ose jo i dhunuar para se të shoqërohej në organet e policisë, gjatë marrjes në pyetje para se të akomodohej në dhomat e sigurisë, apo është dhunuar brenda këtyre ambienteve, personat që e kanë takuar apo dhunuar, datën dhe orën e kryerjes së veprimeve të kundërligjshme, kryerjen e detyrave nga punonjësit e policisë të shërbimit të brendshëm, ofrimi i shërbimit mjekësor, etj. Për këto arsye, është domosdoshmëri monitorimi dhe ruajtja e regjistrimeve nëpërmjet të cilit do të mund të shmangen rastet e dhunës.

Dhomat dhe korridori në mjedisin e shoqërimit monitorohej nga sistemi i kamerave, Administrimi i kamerave kryhej nga specialistët e IT-së në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit. Afati për ruajtjen e pamjeve filmike ishte 14 ditë.

Në Komisaritin e Policisë në Kavajë kryenin funksionin e Oficerëve të Policisë Gjyqësore 11 specialistë policie, që kryenin veprimet proceduriale të marrjes në pyetje të personave të shoqëruar dhe të arrestuar apo të ndaluar. Nga inspektimi i zyrave të punës të OPGJ-ve, nuk u gjetën sende prania e të cilave të ekspozonte dhunë psikologjike/fizike tek personat me të cilët ata kryenin veprime procedurale. Në këtë komisariat kishte një dhomë për administrimin e provave materiale.

Ndërsa për periudhën Janar – Shkurt 2025 në ambientet e këtij komisariati ishin shoqëruar gjithsej 77 persona, 74 burra dhe 3 të mitur. Të dhënat e këtyre personave ishin të evidentuara në regjistrat për personat e shoqëruar.

Gjithashtu konstatuam se në këtë komisariat **zbatohej praktika** për pajisjen e personit të shoqëruar me kartën e të drejtave të personave të shoqëruar, që në momentin e shoqërimit në mjediset e këtij komisariati, kartat e të drejtave ishin të printuara dhe qëndronin tek zyra e oficerit të shërbimit. Avokati i Popullit vlerëson këtë standard të informimit të të shoqëruarve me të drejtat e tyre. Ndërkohë i kërkon OPGJ-ve që të garantojnë që qytetarët që shoqërohen dinë të lexojnë, për të garantuar njohjen efektive të tyre me të drejtat.[6]

Ambientet e sigurisë dhe kushtet e tyre

Ambienti i sigurisë në Komisariatin e Policisë Kavajë, është shpërngulur në Drejtorinë Vendore të Policisë së Shtetit në Durrës që prej datës 16.06.2023.

[6] https://rm.coe.int/1680ae233b, *pika 29, fq.13, raport drejtuar Qeverisë Shqiptare mbi vizitën e KPT në Shqipëri të kryer në datat 4-15 maj 2023.*

Regjistri i personave të shoqëruar, ndaluar/arrestuar si dhe trajtimi i tyre

“Regjistri i evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar”, në Komisariatin e Policisë Kavajë, ishte sipas “Model nr.1”, të përcaktuar në procedurën standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”, miratuar me Urdhrin nr. 894 dt. 19.07.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

Të gjithë personat e shoqëruar në organin e policisë, sipas dispozitave të ligjit nr. 82/2024 “Për Policinë e Shtetit”, regjistroheshin në këtë regjistër nga punonjësit e zyrës së informacionit.

Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se, koha e qëndrimit në gjendje shoqërimi e shtetasve ishte e ndryshme nga 1 orë deri në 5 orë në raste të veçanta, por mesatarisht ata mbaheshin për veprime rreth 4 orë. Rubrikat e regjistrit ishin plotësuar në mënyrë korrekte, me përgjegjësi dhe saktësi nga punonjësit e policisë në zyrën e informacionit.

Grupi i punës konstatoi se mungonte regjistri për evidentimin e kërkesë/ankesave të personave të arrestuar dhe të ndaluar, sikurse parashikohet në nenin 24 “*Trajtimi i ankesave ndaj veprimeve policore*” të ligjit nr. 82/2024 “Për Policinë e Shtetit”.

Ambientet e intervistimit

Në Komisariatin e Policisë Kavajë, nuk ka një dhomë më vehte të monitoruar me sistemin e kamerave, që të shërbejë për intervistimin/ marrjen në pyetje të personave të shoqëruar nga punonjësit e policisë, për të cilët ekzistojnë kushtet e përcaktuara në ligj se ka dyshime të arsyeshme që kanë kryer një vepër penale. Gjithashtu në raportin drejtuar Qeverisë Shqiptare mbi vizitën e Komiteti për Parandalimin e Torturës (KPT) në Shqipëri të kryer në datat 4-15 maj 2023 është evidentuar qartë nevoja e krijimit të dhomave të intervistimit[7]: “*Në fakt, një strukturë e tillë mund të sigurojë një regjistrim të plotë dhe autentik të procesit të intervistimit, duke lehtësuar në masë të madhe hetimin e çdo pretendimi për keqtrajtim. Ky fakt është në interes si të personave që janë keqtrajtuar nga policia, ashtu edhe të punonjësve të policisë që janë përballur me pretendime të pabaza se janë përfshirë në keqtrajtime fizike apo presione psikologjike.*

Në parim, regjistrimi audio-vizual duhet të mbulojë të gjitha fazat e marrjes në pyetje nga policia, duke përfshirë dhënien e informacionit për të drejtat në fillim të intervistës. Kjo do të sigurojë që marrja në pyetje nga ana e policisë të kryhet në përputhje me ligjin dhe do të ndihmojë në parandalimin e çdo praktike të nënshtrimit

[7] Electronic recording of police intervieës (Regjistrimi elektronik i marrjes në pyetje nga ana e policisë) fq,13, https://rm.coe.int/1680ae233b.

të personave të ndaluar në marrje në pyetje joformale përpara marrjes në pyetje zyrtare."

KPT inkurajon autoritetet shqiptare të zgjerojnë aplikimin e regjistrimit audio-vizual të intervistave të policisë për marrjen në pyetje të të gjithë personave të ndaluar.

Avokati i Popullit e konsideron procesin e intervistimit të personave të shoqëruar në një ambient më vete, që të jetë i monitoruar nëpërmjet sistemit të kamerave të sigurisë, si një element parësor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, pasi monitorimi filmik ka efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme, si nga ana e të shoqëruarve, ndaluarve e arrestuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e policisë së shtetit ndaj tyre.

Gjithashtu, edhe intervistimi apo marrja në pyetje e të miturve në konflikt me ligjin që shoqërohen në mjediset e këtij komisariati, kryhej në zyrat e punës të punonjësve të policisë dhe jo në ambiente të veçanta, sikurse është e parashikuar në dispozitat e Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur dhe procedurën standarde[8]. Mekanizmi Kombëtar e konsideron me rëndësi të veçantë faktin se, intervistat me të miturit duhet të realizohen në një ambient të përshtatshëm dhe të pajisur me orenditë e nevojshme si tavolina dhe karrige, në një mjedis sa më të qetë, pa shtrëngime fizike dhe presione psikologjike. Në kushtet aktuale që ndodhen zyrat e punës të punonjësve të policisë, intervistimi i tyre mund të shkaktojë traumatizim plotësues te të miturit. Ka nevojë për ambiente të posaçme për ta, të cilat duhet të vihen në përdorim dhe të cilat duhen në mënyrë të menjëhershme të jenë në funksion.

Ndihma juridike dhe psikologjike

Në Komisariatin e Policisë Kavajë, zbatohej detyrimi ligjor i parashikuar në pikën 6 të nenit 19 të ligjit nr. 82/2024 "Për Policinë e Shtetit" si dhe në kreu VII, pika a.3.4 të procedurave standarde, për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimin e çështjes përkatëse.

Gjatë inspektimit, u bë këqyrja e dokumentacionit që ndodhej në zyrën e informacionit ku rezultoi se, ndaj personave të shoqëruar nga punonjësi i policisë mbahej një procesverbal tip i emërtuar "Formulari i raportit të shoqërimit ose ndalimit/arrestimit", si dhe zbatohej detyrimi ligjor i parashikuar në nenet 34/b, pika 2 dhe 251 të K.Pr.P,

[8] Kreu VII. Pika 2.1/k e procedurës standarde thuhet se: "*I mituri në konflikt me ligjin gëzon të drejtat e parashikuara në Kodin e Procedurës Penale si dhe të drejtat e posaçme të parashikuara në Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur". I mituri duhet të mbahet në dhoma/ambiente të ndarë nga personat madhorë dhe të ndarë nga të miturit e tjerë sipas gjinisë*".

që personit të ndaluar/arrestuar duhet t'i jepet dhe të mbajë me vete një kopje të procesverbalit të ndalimit/arrestimit.

Nga pyetja e punonjësve të policisë rezultoi se në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit madhorë të cilët nuk kishin mundësi financiare për të pajtuar avokat privat kërkonin ndihmë juridike, atyre ju sigurohej mbrojtja me avokat të caktuar kryesisht.

Përgjatë inspektimit në Komisariatin e Policisë Kavajë, u konstatua se kishte një listë të afishuar por të pa përditësuar ku mund të evidentoheshin avokatët kryesisht. Gjithashtu nuk ishte evidentuar në regjistrin e informacionit nëse avokatët kishin qenë të pranishëm. Kjo problematikë është trajtuar në raport drejtuar Qeverisë Shqiptare mbi vizitën e KPT në Shqipëri të kryer në datat 4-15 maj 2023.

KPT-ja bën rekomandime të hartuara për të përmirësuar funksionimin në praktikë të masave mbrojtëse ligjore. Kërkohet veprim për të siguruar që të gjithë personat e shoqëruar nga policia të jenë plotësisht të informuar për të drejtat e tyre që nga fillimi i heqjes së lirisë. KPT- ja gjatë vizitës në organet e policisë së Shtetit ka konstatuar se: "*Ka pretendime se oficerët e policisë kishin pranuar kërkesat e personave të shoqëruar arrestuar/ndaluar për avokat kryesisht vetëm pas një vonese të konsiderueshme, në mënyrë që të mund t'i pyesnin ata në mënyrë joformale për veprën e dyshuar pa praninë e një avokati*"[9].

Përgjatë inspektimit punonjësit e policisë i parashtruan grupit të inspektimit, se në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit ishin të mitur, veprimet procedurale kryheshin në praninë e detyrueshme të avokatit mbrojtës të caktuar kryesisht dhe të psikologut.

Përgjatë inspektimit dhe bisedës me oficerët e policisë gjyqësore konstatuam se **prania e psikologut në fakt nuk sigurohej nga Urdhri i Psikologut**. Me shkresë Nr. 4 Prot., datë 08.01.2024 të gjitha komisariatet në varësi të Drejtorisë Vendore të Policisë Durrës janë informuar në lidhje me përditësimin e listës së psikologëve asistues për të miturit gjatë procesit të intervistimit nga ana e oficerit të policisë, si dhe psikologët e certifikuar si ekspertë asistues dhe vlerësues. Megjithatë, në praktikë psikologët në këtë listë nuk paraqiteshin kur kontaktoheshin nga punonjësit komisariatit por ata siguroheshin nga Bashkia Kavajë.

Në rastet kur të shoqëruarit paraqesin probleme shëndetësore, punonjësit e policisë lajmëronin urgjencën dhe i shoqëronin ata në Spitalin Rajonal Kavajë, për të marrë ndihmën mjekësore.

[9] https://rm.coe.int/1680ae233b, fq nr.3, raport drejtuar Qeverisë Shqiptare mbi vizitën e KPT në Shqipëri të kryer në datat 4-15 maj 2023.

Gjatë inspektimit u konstatua se në korridoret e godinës dhe brenda dhomave të shoqërimit të këtij komisariati ishin afishuar postera me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar në organin e policisë. Megjithatë, këto postera duhet të zëvendësohen me të rinj për shkak të ndryshimeve të ndodhura me miratimin e ligjit të ri "*Për policinë e Shtetit*" e për pasojë nevojiten përditësimet e tyre.

Për sa më sipër dhe me qëllim zgjidhjen e problemeve të konstatuara gjatë këtij inspektimi, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku parashikohet se: "*Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike*" dhe në bazë të nenit 21/b të ligjit nr. 8454 dt.04.02.1999 "*Për Avokatin e Popullit*", i ndryshuar, ku përcaktohet se: "*Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive*",

REKOMANDOJMË:

1. Të merren masat e nevojshme për krijimin e një mjedisi të veçantë për intervistimin e personave të mitur në konflikt me ligjin, i cili të jetë i pajisur me orenditë e nevojshme si tavolina pune për punonjësit e policisë, ndenjëse për qëndrimin ulur të të miturve, kujdestarit ligjor, psikologut dhe avokatit mbrojtës, si dhe të kompletuar me materiale informuese rreth të drejtave të të miturve të njohura nga legjislacioni kombëtar dhe konventat ndërkombëtare.
2. Të merren masat e nevojshme për krijimin e zyrave ku merren në pyetje shtetasit gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në këto zyra.
3. Të merren masat e nevojshme për vendosjen e kamerave brenda dhomave të shoqërimit sipas përcaktimeve në procedurën standarde "*Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit*", miratuar me Urdhrin nr. 894 dt. 19.07.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.
4. Të merren masat e nevojshme për krijimin e hapësirave/sporteleve të dyerve të dhomave të shoqërimit për gra dhe të mitur sipas përcaktimeve në procedurën standarde "*Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit*", miratuar me Urdhrin nr. 894 dt. 19.07.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.
5. Të merren masat e nevojshme për sigurimin e dritareve të dhomave të shoqërimit të grave dhe të miturve sipas Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.894, datë 19.07.2022, për miratimin e procedurës standarde *"Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë".*
6. Marrjen e masave për zëvendësimin e menjëhershëm të posterave me të drejtat e personave të shoqëruar në ambientet e shoqërimit me postera të rinj për shkak të ndryshimeve të fundit ligjore.

7. Të merren masa të menjëhershme për përditësimin e listës së psikologëve të certifikuar si ekspertë asistues dhe vlerësues duke mundësuar zbatimin efektiv të saj.
8. Të merren masat e nevojshme për sigurimin e ngrohjes/ftohjes nëpërmjet vënies në punë të sistemit qëndror në dhomat e shoqërimit dhe të sigurisë, në varësi të stinës dhe temperaturave.
9. Të merren masat për ndërtimin e tualeteve të ndara për gra dhe burra të pajisura me mjetet e domosdoshme për këtë qëllim sipas parashikimeve në procedurën standarde "*Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë*", miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 894, datë 19.07.2022.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor sipas nenit 22 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONERI
i Mekanizmit Kombëtar
për Parandalimin e Torturës
(MKPT)
Ahmet PRENÇI

d.v